
AN ASSESSMENT OF THE DIASERS CONSEQUENCES AND PREPARATIONS FOR FACING THEM

Bahtir Maxhuni

College Biznesi, Prishtina, Republic of Kosovo, tuli-m@hotmail.com, maxhunibahtir@gmail.com

Abstract: The history of the Earth has always been affected by natural disasters, which regardless of our technological advancements, cannot be curbed. Some areas in the world are much more affected by these events, some of which can kill thousands of people. Hence, the disasters are rare events but with a very high impact on the lives of many people. They can be natural disasters or disasters caused by man, considering that the environmental catastrophic risks and pollution have serious consequences. We are aware that natural disasters are caused by natural forces and they are manifested in the form of earthquakes, fire (including forest fires), floods, droughts, avalanches, storms, landslides, hurricanes, volcanic eruptions, etc.

Considering that the climate change is more and more visible and in the rise, manifested by major storms and other disasters, the nature is sending a clear message to us to be more cautious and take preventive measures in order to minimize and channel them, in particular disasters such as earthquakes, tornados, Tsunami, flood, hurricanes, etc. The main climate changes are increasingly caused by these phenomena throughout the world, hence the question: which are the worst natural disasters in the history?

Even though nowadays the mankind has a very developed technology, it still does not have a protection against the nature and the worst destructive disasters. We are witnesses of increasingly frequent disasters such as: hurricanes, tsunami, extreme rainfalls, droughts, dense snowfalls as a result of the climate change. And on the destruction of planet Earth "the mother nature", in a way a light is shed on us through the worst disasters!

One of the common characteristics of natural risks, which applies to the majority of them, is the suddenness of their appearance (e.g. earthquakes, landslides, open fires, etc.) Even though, through scientific and technological advancements to some extent some natural disasters can be predicted as far as their location and time is concerned (e.g. floods, hurricanes, low temperatures, draughts, hail, etc.)

Keywords: assessment, analysis, disaster, floods, earthquakes

NJË VLERËSIM PËR PASOJAT E KATASTROFAVE DHE PËRGATITJET PËR PËRBALLIMIN E TYRE

Bahtir Maxhuni

Kolegji BIZNESI Prishtinë, Kosovo, tuli-m@hotmail.com, maxhunibahtir@gmail.com

Abstrakti: Historia e Tokës ka qenë gjithmonë e ndikuar nga katastrofat natyrore, të cilat pavarësisht nga përparimet tona teknologjike, nuk mund të preken. Disa zona të botës janë shumë më të prekura nga këto ngjarje, dhe disa prej tyre mund të vrasin mijëra njerëz. Pra, katastrofat janë ngjarje të rralla por me një impakt të lartë në jetën e shumë njerëzve. Ato mund të jenë fatkeqësi natyrore ose të shkaktuara nga dora e njeriut, duke e pasur në mendje se rreziqet mjedisore katastrofike dhe ndotja kanë pasoja të rënda. E dimi se fatkeqësitë natyrore shkaktohen nga forcat natyrore dhe manifestohen si tërmetet, zjarret (përfshirë zjarret në pyje), përmytjet, thatësira, orteçet, stuhitë, rrëshqitjet e dheut dhe rrëshqitjet e tokës, uraganet, shpërthimet vullkanike, etj.

Duke pasur parasysh se ndryshimi i klimës është gjithnjë e më i dukshëm dhe në rritje, ku përmes stuhive të mëdha dhe fatkeqësive tjera, natyra na porosin dhe na dërgon mesazh të bëjmë kujdes dhe të ndërmarrim masa preventive për minimizimin dhe kanalizimin e tyre, sidomos nga tërmetet, tornadot, tsunami, përmytjet, uraganet etj. Ndryshimet kryesore klimatike po i shkaktojnë këto fenomene, gjithnjë e më shumë, në të gjithë botën, andaj shtrohet pyetja, cilat janë fatkeqësitë më të këqija natyrore në histori?

Edhe pse njerëzimi ka një teknologji shumë të zhvilluar sot, ende nuk ka mbrojtje kundër natyrës dhe katastrofave shkatërruese më të këqija. Ne jemi dëshmitarë të katastrofave gjithnjë e më të shpeshta siq janë; uraganet, tsunami, reshjet ekstreme, thatësira dhe reshjet e dendura të borës si rezultat i ndryshimit të klimës. Dhe për shkatërrimin e planetit Tokë, ajo "**natyrë nënë**" në një farë mënyre ndriçon një dritë mbi ne përmes fatkeqësive më të këqija përditë!

Një nga karakteristikat e zakonshme të rreziqeve natyrore, e cila vlen për shumicën e tyre, është papriturësia e shfaqjes (p.sh. tërmetet, rrëshqitjet e tokës, zjarret në hapësirë të hapur, etj.), Megjithatë, përmes përparimeve

shkencore dhe teknologjisë moderne, disa tashmë mund të parashikohen fatkeqësitë natyrore sipas vendndodhjes dhe kohës (p.sh. përmbytjet, uraganet, temperaturat e ulëta, thatësira, breshri etj.

Fjalët kyçe: vlerësimi, analiza, katastrofa, përmbytjet, tërmetet...

1. HYRJE

Të gjitha shtete kanë për detyrë që të japin siguri për jetën dhe pasurin e qytetarëve të tyre qoftë në aspektin e përhershëm apo të përgjithshëm, andaj për të arritur këtë duhet të bëhet analiza dhe vlerësimi i rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore duke përfshirë edhe katastrofat. Për ta bërë këtë analizë dhe vlerësim të rreziqeve sa më të saktë kërkohet që çdo element të rregullohet me infrastrukturë ligjore.¹⁸⁹ Për vetë faktin se të gjitha fatkeqësitë natyrore të shkaktuara nga dukuritë natyrore apo nga njeriu, mund të rrezikojnë jetën e njerëzve, kafshëve, të mirat materiale, ambientin, infrastrukturën kritike dhe trashëgiminë kulturore. Të gjitha këto dukuri, qofshin ato natyrore apo të shkaktuara nga faktori njeri, manifestohen me rreziqe dhe paraqesin sfida me të cilat ballafaqohet njerëzimi. Andaj, çmimi ekonomik dhe shoqëror i katastrofave natyrore është në rritje e sipër në mbarë botën.¹⁹⁰ Prandaj, analizat, vlerësimi dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërmarrja e masave, veprimeve dhe aktiviteteve për parandalimin e tyre, duhet të jenë prioritetet për të gjitha shtetet në rajon e më gjerë.¹⁹¹ Të gjitha vendet e botës janë të ekspozuara nga rreziqet të cilat në shkallë dhe përmasa të ndryshme paraqesin kërcënim për sigurinë fizike, pasurinë dhe interesat e vendit. Në të gjitha periudhat e zhvillimit të njerëzimit, vende dhe rajone të ndryshme kanë qenë të prekura nga fatkeqësitë e ndryshme siç janë: tërmetet, vullkanet, stuhitë, shtrëngatat, ciklonet, vërshimet, përmbytjet, ortekët, shembjet, rrëshqitjet, eksplozimet, etj..., të cilat janë manifestuar me përmasa dhe pasoja nga më të ndryshmet. Komuniteti, i vetëdijshëm për efektet dhe pasojat e këtyre rreziqeve çdo ditë e më shumë është duke i kushtuar rëndësi të veçantë vlerësimit dhe menaxhimit të FNFT-së dhe vënies nën kontroll të tyre. Për ta bërë vlerësimin e rrezikut dhe analizën e saj të një vendi duhet të merren për bazë disa faktorë relevantë që janë pjesë përbërëse të vlerësimit, duke u nisur nga pyetjet: Çka mund të ndodh? Sa shpesh mund të ndodh? , Dëmi që ka gjasa të shkaktohet? Sa ka gjasa të ndikojë në komunitet? , Sa është i cenueshëm komuniteti ndaj rrezikut ?.

Andaj duke marr për bazë këto pyetje, duhet pasur parasysh pesë hapat e procesit të analizimit të rrezikut siç janë: 1. Identifikimi i rrezikut. 2. Profilizimi i secilit rrezik. 3. Ndërtimi i profilit të komunitetit. 4. Përcaktimi i cenueshmërisë. 5. Krijimi dhe aplikimi i skenarit.¹⁹²

2. NDIKIMI DHE PASOJAT E FATKEQËSIVE NATYRORE-KATASTROFAVE NË VENDE TË NDRYSHME

Tronditjet e mëdha a krizat që krijohen e që sjellin shkatërrim në jetën familjare apo shoqërore, dështim i madh apo i bujshëm, falimentimin e plotë e të rëndë, kjo do të jetë katastrofë.¹⁹³

Një përkufizim që mund të përdorim në vijim (Lito et al. 2011) për katastrofat do të jetë: **Katastrofa** është një ngjarje e befasishme shkatërrimtare, e cila shkakton humbje të mëdha njerëzore, materiale dhe ambientale, të cilat tejkalojnë mundësinë e komunitetit të prekur t'a përballojë duke përdorur burimet e veta.¹⁹⁴ Po ashtu kemi përkufizimin tjetër kur thuhet se:

Katastrofa nënkupton, ngjarje të jashtëzakonshme që për pasojë ka ndërprerjen të dukshme të funksionimit të bashkësisë dhe shkakton viktima të mëdha të viktimave njerëzore, shkatërtime materiale dhe goditje të ambientit e cila i tejkalon aftësitë bashkësisë së goditur për ti zgjidhur me përdorimin e forcave dhe mjeteve vetanake.¹⁹⁵

Smith (1996) ka përcaktuar ndërmjet të tjerash që një katastrofë të mund të quhet e tillë duhet që si pasojë e ngjarjes:

- Dëmi ekonomik të jetë mbi 1% të Produktit Kombëtar Bruto (PKB)
- Popullsia e ndikuar nga ngjarja të jetë mbi 1% e popullsisë së një vendi.¹⁹⁶

Disa shkencëtarë mendojnë se ndryshimet që ka shkaktuar njeriu në atmosferën e tokës dhe në oqeanë, e kanë kthyer planetin tonë në një vend të rrezikshëm, duke çuar në katastrofa natyrore më të shpeshta e më të rënda. Veç kësaj, e

¹⁸⁹ Dr. Kudusi Lama, Analiza dhe vlerësimi i rreziqeve, Kolegji Biznesi, Prishtinë, fq 178

¹⁹⁰ Menaxhimi i krizave/emergjencave, manual, Prishtinë, Nentor 2009, fq 4

¹⁹¹ Vlerësimi i rreziqeve nga FNFT, Prishtinë, fq 6

¹⁹² Vlerësimi i rreziqeve nga FNFT, Prishtinë, fq 27

¹⁹³ Dr. Kudusi Lama, Analiza dhe vlerësimi i rreziqeve, Kolegji Biznesi, Prishtinë, fq 31

¹⁹⁴ Lito et al (2011), Manaxhimi i riskut të katastrofave, Qendra Shqiptare për Riskun – Konferenca III Ndërkombëtare proceedings, faqe 236

¹⁹⁵ Planifikimi I ngjarjeve me ndikim të lartë dhe masat e sigurisë, fq 53

¹⁹⁶ Smith K. (1996) "Environmental Hazards. Assessing risk and reducing disaster", Routledge, faqe 29

ardhmja duket e pasigurt. “Jemi në mes të një eksperimenti të madh e të pakontrollueshëm, i cili po zhvillohet në të vetmin planet ku jetojmë”,—thuhej në revistën *Science* në një artikull rreth ndryshimit të klimës.

Andaj duke u bazuar në dëmet që mundë të shkaktoj kjo dukuri negative efektet mundë të jenë katastrofale në pikëpamjen e dëmeve të shkaktuara kryesisht në dekadat e fundit, ku mundë të themi së janë dy arsye që shpjegojnë këtë fenomen. Së *pari* vetëm në dy apo tri dekadat e fundit janë matur po thuajse me saktësi efektet e katastrofave, duke u bazuar në zhvillimin e IT. Së *dyti*, për shkak të rritjeve dhe përqendrimit të numrit të popullsisë gjithashtu rritjes dhe përqendrimit të pasurisë, ku katastrofat godasin qytete të mëdha me miliona banorë dhe shaktojnë dëme me vlera shumë të mëdha materiale.¹⁹⁷

Pra, që të kuptojmë më mirë se si njerëzit mund të ndikojnë në shpeshësinë dhe në forcën e katastrofave natyrore, duhet t'i kuptojmë paksa dukuritë natyrore bazë. Për shembull, çfarë i shkakton stuhitë e forta, si uraganet, etj? Për këtë masat edhe aktivitetet para katastrofës, janë parandalimi i cili mundë të definohet si masat të cilat kanë për qëllim ta ndalojnë shfaqjen e katastrofës, apo ta parandalojë që ndonjë këso ndodhie të ketë pasoja të minimizuara në komunitete dhe në instalimet kyçe.¹⁹⁸

Pasojat katastrofave që kanë shkakuar në disa vende të botës, si më poshtë:

- **Ciklon tropikal**

Ishte cikloni më i keq që është regjistruar ndonjëherë për të goditur Indinë dhe Bangladeshin (Lindja e Pakistanit) në 12 nëntor 1970. Cikloni më vdekjeprurës ka marrë më shumë se 300,000 jetë.

- **Përmbytje e madhe**

Në Kinë, në gusht 1931, lumenjtë Huai, Huang dhe Yang Ceng Yang përmbytën. Shtrati i tre lumenjve bëri që përmbytja më e madhe të godiste 4 milion njerëz. Pirja, nuk ishte shkaku i vetëm i vdekjes, gjegjësisht, përmbytja çoi në sëmundje të ndryshme të shkaktuara nga uji i ndotur.

- **Tërmeti më i madh**

Tërmeti më i madh i regjistruar u godit në Kili më 22 maj 1960. Tërmeti 9,5 Richter shkaktoi një cunami 25 metra që vrau 1.600 njerëz dhe një ditë më vonë goditi brigjet e Hawai dhe Japonia, duke vrarë 200 njerëz të tjerë.

Apo, tërmetet e vitit 1999 në Turqi shaktuan sipas OECD 18,000 viktima, si dhe shkatërrimin apo dëmtimin e 300,000 banesave dhe 46,000 bizneseve, me një humbje totale makroekonomike të vlerësuar në 10 miliardë USD. Pas këtyre ngjarjeve u krijua Fondi Turk i Sigurimit nga Katastrofat, i cili ofron mbulim të detyrueshëm sigurimi nga tërmetet për të gjitha banesat në vend, çmimi i të cilave përcaktohet në mënyrë të efektshme.

- **Shpërthim katastrofik vullkanik**

Më 8 maj 1902, një shpërthim katastrofik vullkanik ndodhi në ishullin francez Martinique në Karaibe, duke vrarë rreth 30,000 njerëz. Nga numri i të vdekurve, ishte shpërthimi vullkanik më vdekjeprurës në të gjithë shekullin e 20-të. Pothuajse shkatërroi plotësisht qytetin e San Pierre, në atë pikë vendbanimi më i madh në ishull.

3. VLERËSIMI ANALITIK I PASOJAVE NGA FATKEQËSIT

Pas çdo fatkeqësie natyrore-katastrofale, duke u bazuar në mbledhjen e të dhënave në teren nga të caktuarit e secilit dikaster që ka vepruar në ngjarje-incident për ti ndihmuar menaxhimin të resurseve njerëzore coftë në aspektin planifikues apo ekzekutues duhet të gjitha të thënat të inkorporohen në një vend dhe të bëhet vlerësimi analitik për pasojat e shkaktuara pas veprimit në përgjithësi. Vlerësimi bëhet njëherë në fund të të përfundimit të punës nga grupi punues i ngarkuar me detyrë për të bërë analizën dhe vlerësimin e rreziqeve.¹⁹⁹

Rrezikimet në botën aktuale janë të shumta dhe komplekse, të llojeve nga më të ndryshmet, por në interes të trajtimit më të plotë të tyre, veçmas në interes të masës dhe nivelit të rrezikimit dhe rrezikshmërisë, zakonisht klasifikohen në llojet si në vijim :

- Rrezikimi **natyror**, rezultat i pasojave potenciale dhe reale të fenomeneve natyrore (tërmetet, vërshimet dhe fatkeqësitë të tjera). Këto fatkeqësi shkaktojnë edhe varg të dukurive të tjera të dëmshme, sikurse : paniku, plaçkitja, zjarri etj.
- Rrezikimi **tekniko – teknologjik**, rezulton me ndotjen e ambientit nga përdorimi i mjeteve teknike bashkëkohore.

Federata Ndërkombëtare e Shoqatave të Kryqit të Kuq dhe Gjysmë Hënës së Kuqe thotë se gjatë dekadës së kaluar, katastrofat gjeofizike dhe të lidhura me motin janë shtuar mbi 60 për qind.²⁰⁰

¹⁹⁷ Dr. Kudusi Lama, Analiza dhe vlerësimi i rreziqeve, Kolegji Biznesi, Prishtinë, fq 42

¹⁹⁸ Menaxhimi i krizave/emergjencave, manual, Prishtinë, Nentor 2009, fq 9

¹⁹⁹ Dr. Kudusi Lama, Analiza dhe vlerësimi i rreziqeve, Kolegji Biznesi, Prishtinë, fq 246

²⁰⁰ Raportin botëror të katastrofave natyrore të vitit 2004, fq 45

Nëse popullsia në zonat e rrezikuara vazhdon të shtohet dhe pyjet vazhdojnë të pakësohen, zor se gjenden arsye për optimizëm.

Veç kësaj, shumë vende të industrializuara lëshojnë në atmosferë gjithnjë e më tepër gaze që shkaktojnë efektin serrë. Sipas një artikulli në revistën *Science*, të zvarritësh pakësimin e gazeve që lëshohen në atmosferë është si të refuzosh ilaçet për një infeksion që po zhvillohet; kjo të garanton se më vonë do të paguash një kosto më të lartë.

Duke folur për këtë kosto, një artikull kanadez për lehtësimin e katastrofave, thoshte: Mund të thuhet se ndryshimi i klimës është çështja më e diskutuar rreth mjedisit dhe me pasoja më të mëdha që ka hasur familja botërore. Por, sot shtetet nuk janë në një mendje nëse ndikon ose jo veprimtaria e njerëzve të ngrohja globale, e aq më pak ta zgjidhin këtë problem. Kjo situatë të sjell ndër mend një të vërtetë biblike: Njeriu që ecën nuk ka fuqi të drejtë hapat e tij. Megjithatë, siç do ta shohim në artikullin vijues, gjendja nuk është e pashpresë. Në fakt, mjerimet e tanishme, përfshirë edhe jetën e stuhishme të njerëzve sot, i shtohen provave që tregojnë se shpëtimi është afër.

4. PËRGATITJA PËR BALLAFAQIMIN ME FATKEQËSIT NATYRORE-KATASTROFAT

“**Bëni diçka!**”²⁰¹ Ky mesazh i thjeshtë është gjëja e parë që dëgjojnë qeveritë kur ngjarje të tmerrshme si tërmeti në Japoni apo në Haiti, shfaqen në kronikat e lajmeve. Ky është dhe mesazhi që përkrahësit e uljes së rrezikut të katastrofave kanë dhënë në dy dekadat e fundit; nuk mjafton, kemi argumentuar ne, për t’u përgatitur kundër katastrofave, shtetet duhet të bëjnë shumë më tepër për të parandaluar që ato të ndodhi.

Njohja dhe zbatimi i detyrave për përgatitjen shtetërore për situatë emergjence është një nga përgjegjësitë strategjike, për te pasur te mobilizuar organizuara të gjitha burimet njerëzore e materiale – teknike për te përballuar gjithnjë me sukses çdo situatë emergjence që mund të shfaqet.²⁰²

Një komponent shumë i rëndësishëm i menaxhimit të katastrofave në çdo vend është baza ligjore, andaj Ligjet zvogëlojnë rreziqet dhe rrisin efektin e përgjigjes ndaj katastrofave.²⁰³ Aspektet ligjore, shpesh, janë të pa dukshme në raste emergjente, por ligjet efektive përforcojnë sigurinë e jetës dhe të pasurive tona, rrisin efektin e përgjigjes për raste emergjente dhe garantojnë në suksesin për t’u rimëkëmbur kur ka ndodhur katastrofa.

Brenda sistemit ligjor të Kosovës ekzistojnë një numër ligjesh që ndihmojnë mbrojtjen e shoqërisë civile dhe detyrimin e praktikës së mirë.

Në vendin tonë, legjislati primar që ka të bëjë me fatkeqësitë natyrore është Ligji Nr. 04/-L-027, “Për fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera”, i cili është ligji i parë në historinë e legjislatit të shtetit tonë, i përmbledhur në këtë fushë, po ashtu kemi Planin e Reagimit Kombëtar,²⁰⁴ ku qëllimi i saj është vendosja e qasjes gjithëpërfshirëse kombëtare për menaxhmentin e incidenteve ndaj të gjitha rreziqeve në spektrin e plot të aktiviteteve të parandalimit, gatishmërisë, reagimit dhe rimëkëmbjes. Për më shumë, Plan Kombëtar i Reagimit ofron një kornizë për një qasje kombëtare në menaxhimin e incidenteve, ani pse ky dokument ende mbetet të zbatohet në tërësi. Brenda këtij plani, rolet dhe përgjegjësitë e qarta u përcaktohen institucioneve të ndryshme qeveritare në nivelet qendrore dhe rajonale. Rolet²⁰⁵ dhe përgjegjësitë janë po ashtu mirë të përcaktuara edhe për qeveritë lokale, si dhe për sektorin privat e organizatat joqeveritare. Ai është i strukturuar në harmoni me Sistemin e Integruar për Menaxhim të Emergjencave (SIME).

Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave, siguron një orientim strategjik, në ngritjen e përgjegjësisë, përkushtimit dhe koordinimit të shërbimeve mes akterëve si para dhe pas incidenteve një qasje sistematike, pro-aktive.²⁰⁶ SIME organizon menaxhimin e incidenteve të emergjencës në të gjitha nivelet, duke reflektuar për së afërmi sistemin komandues të incidenteve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Të dy këto dokumente përmbyllin gatishmërinë për reagim dhe ishin zhvilluar me pjesëmarrje të gjithë akterëve kyç, ku e dimë se Kosova në aspektin e FNFT është e rrezikuar nga tre rreziqet natyrore që janë tërmetet, vërshimet dhe zjarret pyjore.

Por për të u përballuar gjegjësisht për të qenë të gatshëm me u merr me fatkeqësitë natyrore paraprakisht duhet të jesh i përgatitur mirë qoftë në aspektin taktik apo metodik, dhe psikik duke krijuar njëherësh të ndërtosh skenarë duke u bazuar në interesat shtetërore të përcjellura me objektiva të caktuara për secilin interes shtetëror, qdo here mos i lan anash infrastrukturën ligjore. Menaxhimi i fatkeqësive të mëdha mbetet shumë i centralizuar, ndërsa kompetencat dhe përgjegjësitë e caktuara për strukturat qeveritare lokale, nuk shoqërohen me financimin e nevojshëm, pasi buxheti i këtyre strukturave shpesh është i pamjaftueshëm.

²⁰¹ Revista Kryqi I Kuq, Nr. 57 i botimit, Janar - Mars 2013, fq 4

²⁰² Dr. Kudusi Lama, Pwrgaditjet shtetërore pwr situatat emergjente, Prishtinw, fq 43

²⁰³ Revista Kryqi I Kuq, Nr. 57 i botimit, Janar - Mars 2013, fq 6

²⁰⁴ Plani I Reagimit Kombëtar, Prishtinë, viti 2009, fq 5

²⁰⁵ Vlerësimi i Kapacitetit për Zvogëlim të Rrezikut nga Fatkeqësitë, fq 15

²⁰⁶ Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave, viti 2010, Prishtinë, fq 4

Institucionet shtetërore, duhet të krijojnë atmosferë të sigurt që të jetë e gatshme që në çdo kohë të i dalë qytetarëve në ndihmë, nëse do të ketë ndonjë fatkeqësi, duke përgatitur stimulime, skenarin, ushtrime për ti demonstruar dhe testuar të gjitha kapacitete të mbrojtjes së qytetarëve nga fatkeqësitë natyrore. Platformë për zvogëlimin e rreziqeve të jetë e disponueshme, në fushën e gatishmërisë, trajnimet, zjarrfikësit, shërbimet mjekësore, duke u bazuar se mundë të kemi rreziqe të paparashikueshme, për shkak të ndryshimeve klimatike.

4.1. PËRGATITJA E TË GJITHA KAPACITETEVE SHTETËRORE NË RAPORT ME KATASTROFAT

Para se gjithash duhet të vendosen interesat shtetërore të pasuara më pas me objektivat e tyre dhe dalia në pah kërcënimet se nga kush mundemi të rrezikohemi, **psh. si interes shtetëror** është: Jeta, mirëqenia, prona dhe siguria e qytetareve, ku **si objektiv e saj** themi se është; Mbrojtja e jetës dhe pronës, Rritja e mirëqenies sociale për te gjithë qytetaret, Garantimi i sigurisë se përgjithshëm te qytetareve, (pasi jemi duke u marrë me fatkeqësi natyrore, qasemi vetëm në incidentet natyrore), duke i radhitur në drejtkëndëshin 90 shkallë në bazë të dy shtyllave siç janë **probabiliteti** /mundësit dhe **konsekuencat**/pasoja. Përgatitim skenarin që ka të bëjë me katastrofat dhe pasojnë me ushtrime tavolinë deri te ushtrimet fushore me të gjitha kapacitetet tona që i kemi duke i testuar strukturat tona në aspektin e parandalimi, reagimi, ndalimit, ndihmës dhe rimëkëmbjes.

5. PËRFUNDIMI

Për të bërë vlerësimi e rrezikshmërisë nga katastrofat duhet të merren për bazë të gjitha dukurit që ndodhin nga fatkeqësitë natyrore dh të behët një mbledhje e të të dhënave në gjithë terrenin e vendit duke marrë për bazë pozitën gjeografike.

Dukuritë dhe fenomenet, qofshin ato natyrore apo të shkaktuara nga faktori njeri, manifestohen me rreziqe dhe paraqesin sfida me të cilat ballafaqohet njerëzimi duke filluar nga periudhat e zhvillimit të njerëzimit, vende dhe rajone të ndryshme që kanë qenë të prekura nga fatkeqësitë andaj, vlerësimi dhe menaxhimi i rreziqeve nga katastrofat dhe aktivitetet për parandalimin e tyre, duhet të jetë prioritetet i vendit, duke marrë parasysh se të gjitha vendet e botës se janë të ekspozuara nga fatkeqësitë natyrore. Rreziqet dhe kërcënimet e mundshme të cilat mund të shkaktojnë ndodhjen e fatkeqësive natyrore kryesisht katastrofat, varësisht nga shkaktari i tyre, renditen në: natyror, tekniko-teknologjike, veprime luftarake dhe terroriste etj.

Vlerësimi i autoriteteve bazohet në analizën e rreziqeve dhe pasojave të mundshme në popullatë, të mira materiale, kulturore dhe mjedis nga: vërshimet, tërmetet si dhe shkaktarët e tjerë natyror, veçanërisht atyre që bien në kategorinë e kushteve ekstreme atmosferike, siç janë: thatësira, valët e nxehta, shtrëngatat, erërat e forta, rrëshqitjet e dheut dhe dëborës, breshëri dhe ngricat etj.

Sa i përket përballimit me katastrofa duhet të krijohet infrastruktura ligjore të përcjellore me strategji konkrete, plane të veprimit, ndarja dhe dhënia e përgjegjësisë për secilin dikaster shtetëror dhe përgatitja dhe mbajtja e ushtrimeve fushore në operativ duke u mbështetur në standardet operative emergjente.

LITERATURA

- Lama, K., Analiza dhe vlerësimi i rreziqeve, Kolegji Biznesi, Prishtinë,
Lito et al (2011), Menaxhimi i riskut të katastrofave, Qendra Shqiptare për Riskun – Konferenca III
Ndërkombëtare proceedings,
Smith, K., (1996) “Environmental Hazards. Assessing risk and reducing disaster”.
Menaxhimi i krizave/emergjencave, manual, Prishtinë, Nentor 2009,
Vlerësimi i rreziqeve nga FNFT, Prishtinë,
Plani I Reagimit Kombëtar, Prishtinë, viti 2009,
Vlerësimi i Kapacitetit për Zvogëlim të Rrezikut nga Fatkeqësitë,
Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave, viti 2010, Prishtinë,
Revista Kryqi I Kuq, Nr. 57 i botimit, Janar - Mars 2013,
Raportin botëror të katastrofave natyrore të vitit 2004
Planifikimi I ngjarjeve me ndikim të lartë dhe masat e sigurisë,